



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATIVES - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nrfaq/Br.str. <u>80</u>
Data/Datum. <u>08.06.2015</u>
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 04.06.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.05.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 317, të datës 15.05.2015, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (h), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 7 dhe nenin 27, shkronja (g), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Z. Mexhid (Abedin) Mehmeti, i lindur më 11 Qershor 1948, në fshatin Zhunicë të komunës së Preshevës, punoi si mësimdhënës në Gjimnazin 'Skënderbeu' në Preshevë, si gazetar, shkrimtar e publicist, shpallet "Qytetar nderi", i komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2015.
2. Z. Mexhid (Abedin) Mehmeti, ka dhënë kontributin e tij për dekada në arsim, gazetari e publicistikë, është autor i disa shkrimeve, veprave letrare e publicistike të botuara si: poezi, poema, tregime, novela, romane, e tjera.
3. I lartëcekuri gëzon privilegjet e parapara për titullin "Qytetar nderi" i komunës së Fushë-Kosovës.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së KRS, z. Mexhid Mehmeti dhe Arkivës.**



**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi**



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATIVES - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJO	
Wrfaq/Dr.ste.	79
Data/Datum.	08.06.2015
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	



Datë: 04.06.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.05.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 317, të datës 15.05.2015, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Komisionit për hartimin e 'Rregullores për caktimin e kushteve dhe kritereve për ndarjen e titujve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:
 - 1.1 Sabit Bullatovci - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i LDK-së;
 - 1.2 Migjen Kolshi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i PDK-së;
 - 1.3 Shaban Ademi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i AKR-së;
 - 1.4 Nuriye Avdiu - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - 1.5 Halil Qerimi - Nënkrjetar i Komunës për Komunitete;
 - 1.6 Ali Topalli - Zyrtar i Informimit;
 - 1.7 Vesa Ibrahim - Përfaqësuese e Shoqërisë Civile.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit është hartimi i 'Rregullores për caktimin e kushteve dhe kritereve për ndarjen e titujve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve'.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Hadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.06.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.05.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 376, të datës 17.12.2014, paraqitur nga Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (I), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 3, paragrafi 1, pika 1.3, nenin 4, nenin 5, nenin 7, nenin 8, të 'Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës' Nr. 04/L-144 (Gazeta Zyrtare Nr.35/2012), nenin 2, nenin 4, të Rregullores të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Nr. 23/2013, nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për fillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) vite, të Ngastrës Kadastrale Nr. P-72514049-00402-0, në sipërfaqe prej 40799m², në vendin e quajtur "Kod Dubova", e evidentuar në Fletën Poseduese, me numër të certifikatës Nr. 25-2653, në Zonën Kadastrale Bardh i Vogël dhe Ngastrës Kadastrale Nr. P-72514049-00203-0, në sipërfaqe prej 1211m², në vendin e quajtur "Kod Dubova", e evidentuar në Fletën Poseduese, me numër të certifikatës Nr. 25-2652, në Zonën Kadastrale Bardh i Vogël, përmes procedurës së ankandit publik.
2. Për dhënien në shfrytëzim të ngastrave kadastrale, të cekur në pikën një (1) të vendimit, formohet 'Komisioni për vlerësimin e ofertave', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:
 - 2.1. Sabri Rexhepi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i LDK-së;
 - 2.2. Sokol Duraku - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i PDK-së;
 - 2.3. Hasan Krasniqi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i AAK-së;
 - 2.4. Ejup Qyqalla - Shef i Shërbimeve Publike;
 - 2.5. Milanka Bojkoviç - Zyrtare e Lartë e Financave;
 - 2.6. Faik Dedinca - Zyrtar i Agrokulturës;
 - 2.7. Vesa Ibrahim - Përfaqësuese e Shoqërisë Civile.
3. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit është që të bëjë vlerësimin e ofertave dhe ofertat ekonomikisht më të favorshme, në pajtim me kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore

për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, i propozon në Kuvendin e Komunës për miratim.

4. Kryerja e detyrave për zhvillimin e procedurave për ankandin publik dhe procedurave tjera, është në kompetencë të Drejtorisë së Administratës - Zyrës së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës.
5. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së Administratës, Drejtorisë së GJKP dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Mr. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.06.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.05.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 62, të datës 19.05.2015, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (e), nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (a, b, c, ç, d, dh), të Statutit të Komunës Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komiteteve tjera sektoriale në komunën e Fushë-Kosovës, si vijon:

- 1.1 Komitetin për Zhvillim Ekonomik;
- 1.2 Komitetin për Planifikim Urban, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- 1.3 Komitetin për Arsime, Kulturë, Rini dhe Sport;
- 1.4 Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- 1.5 Komitetin për Mbrojtje dhe Shpëtim;
- 1.6 Komitetin për Bujqësi dhe Ujëra dhe
- 1.7 Komitetin për Persona me Aftësi të Kufizuara.

2. Numri i anëtarëve, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve tjera sektoriale në komunën e Fushë-Kosovës, do të caktohen me Rregullore, mbështetur në nenin 40, paragrafi 40.2, të Statutit të Komunës.

3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nrfaq/Drstr.	76
Data/Datum.	08.06.2015
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	



Datë: 04.06.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.05.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 62, të datës 19.05.2015, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Komisionit për hartimin e 'Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera në komunën e Fushë-Kosovës', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:
 - 1.1 Nazmi Kelmendi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i LDK-së;
 - 1.2 Fazile Sejdiu - Anëtare e Kuvendit të Komunës, përfaqësuese e PDK-së;
 - 1.3 Trandolina Duli - Anëtare e Kuvendit të Komunës, përfaqësuese e LVV-së;
 - 1.4 Jakup Tërnavë - Drejtor i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës;
 - 1.5 Bahrije Hasolli - Shefe e Zyrës Ligjore;
 - 1.6 Hasan Gjyreveci - Shef i Kuvendit dhe Komiteteve;
 - 1.7 Gëzim Hoti - Përfaqësues i Shoqërisë Civile.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit është hartimi i 'Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera në komunën e Fushë-Kosovës'.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.06.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.05.2015, pas shqyrtimit të Njoftimit Nr. 269, të datës 29.04.2015, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në nenin 17, shkronja (r), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (m), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për lejimin e ridestinitimit të mjeteve financiare, në shumë prej 8125€ dhe përdorimin e tyre, nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Zëri i Kosovës", nga Fushë-Kosova, për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrje në Festivalin Ndërkombëtar të Turqisë.
2. Mjetet financiare të ridestinuara nga pika një (1) e vendimit, lejohen për mbulimin e shpenzimeve për:
 - 2.1 Transportin me autobus;
 - 2.2 Pagesa për marrjen e vizave;
 - 2.3 Ushqim dhe pije gjatë udhëtimit;
 - 2.4 Shpenzime tjera të nevojshme.
3. Sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i komunës, sipas pikës një (1) të vendimit dhe kryerja e procedurave tjera, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Zyrës së Prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës dhe shfuqizon vendimin Nr. 82 të datës 01.07.2014.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së KRS, Zyrës së Prokurimit dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi